

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare
“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN
E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”
24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri

PROBLEME TË TREGUT FINANCIAR JO BANKAR NË SHQIPËRI

Alqi NAQELLARI¹
Greta ANGJELI²
Migena MUSLLI³

Abstrakt

Sistemi financiar në Shqipëri përbëhet nga institucionet financiare bankare dhe jo bankare. Institucionet bankare zënë mbi 92% të tregut financiar. Në këtë punim fokusuar në (2013-2017) në tregun financiar jo bankar të mbikëqyrur nga AMF, synohet të përcaktohen arsyet pse tregu financiar jo bankar nuk ka vendin, rolin dhe rëndësinë e duhur në tregun financiar në përgjithësi.

Në material janë analizuar tregu i sigurimeve, pensioneve dhe i investimeve, është përcaktuar struktura dhe dinamika e tyre si dhe shkalla e përqendrimit të tyre dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e tregut në përgjithësi. Konstatohet që në tregun financiar jo bankar dominon tregu i sigurimeve, i cili është përgjithësisht i strukturës oligopol, i shoqëruar me efektet negative të kësaj strukture. Në vetë këtë treg, dominojnë sigurimet e detyruara që në dinamikën e tyre kanë një rritje të lehtë, ndërsa produktet e sigurimit vullnetar dhe të tregut të jetës janë ende në përqindje të pakonsiderueshme dhe paraqiten me një zhvillim të dobët. Në kushtet kur në vitet e fundit përmbytjet nga lumenjtë kanë filluar të bëhen një fenomen i zakonshëm, është e rekomanduar që AMF të intensifikojë punën për të realizuar edukimin mbi domosdoshmërinë e sigurimit të jetës, shtëpive, bagëtive, të mbjellave etj. që deri sot janë në përmasa të ulëta.

Në material janë përdorur metodat statistikore, indekset e përqendrimit HHI, CR₄, CR₃, HTI, etj., metodat e krahasimit dhe të përshkrimit.

Fjalë kyçe: AMF, siguracione, siguracione vullnetare, të detyrueshme, të jetës, institucione financiare jo bankare, PBB, prime sigurimi, dëme, etj.

¹ Pedagog, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Dekan i Fakultetit të Ekonomisë. alqinaqellari@umsh.edu.al

² Pedagoge, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Zv.Rektore gretaangjeli@umsh.edu.al

³ Studente Masterit në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë